



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 41 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-40, Udhëzimit Administrativ nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, nenet 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenit 35 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, si dhe dispozitave të Rregullores (Komunale) për punën e Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01/146-11 të datës 29 prill 2010, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2025, mori këtë:

V E N D I M **PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË** **PODUJEVËS**

Neni 1

z.Isak Shabani, nga fshati Orllan, Komuna e Podujevës, zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Mandati i Kryesuesit të Kuvendit ndërlihet dhe është në kohëzgjatje të njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 3

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore të nivelit qendror dhe ato të Komunës.

Neni 4

Kryesuesi i Kuvendit, për punët dhe angazhimet në kuadër të kompetencave dhe fushëveprimtarisë së Kuvendit, kompensohet konform legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot.01-112/02-0082943/25
Podujevë, datë, 29 dhjetor 2025

